



Zyra e Shtypit  
15 tetor 2009

## Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009

### 1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË

**Tabelë 1:** Vëllimi i operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë\*).

DATA	R/REPO njëjavore me çmim fiks	R/REPO tremujore
02.04.2009	12,240.00	
09.04.2009	10,420.00	
16.04.2009	20,495.00	
23.04.2009	16,265.00	2,000.00
30.04.2009	15,470.00	5,990.00
07.05.2009	17,900.00	3,000.00
14.05.2009	15,200.00	
21.05.2009	17,200.00	
28.05.2009	17,500.00	
04.06.2009	17,450.00	
11.06.2009	18,420.00	2,840.00
18.06.2009	19,250.00	3,000.00
25.06.2009	18,950.00	

#### 1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektimin e likuiditetit.

Për të injektuar likuiditetin, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, *marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor*, mesatarisht 16.68 miliardë lekë\* në javë si dhe instrumentin rregullues me maturim më të gjatë se një javë - *marrëveshjen e riblerjes me maturim 3-mujor*. Instrumenti rregullues u përdor në 5 raste, mesatarisht 3.4 miliardë lekë për ankand\*.

#### 1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse


Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009, depozita njëditore gjeti përdorim të ulët, pasi në fund të tremujorit të parë, në funksion të nxitjes së qarkullimit të likuiditetit, Banka e

Shqipërisë vendosi të mos pranojë përkohësisht depozita njëditore. Vendimi për mospranimin e depozitave zgjati deri në fund të muajit maj 2009. **Mospranimi i depozitave të bankave për këtë periudhë rriti vëmendjen e tyre për miradministrimin e likuiditetit, çka solli edhe përdorimin e pakët të këtij instrumenti pas vendimit për ripranimin e depozitave njëditore.** Ky instrument u përdor mesatarisht 0.14 miliardë lekë në ditë gjatë muajit qershor, në krahasim me 1.04 miliardë lekë në ditë gjatë tremujorit të parë të këtij viti.

Instrumenti i kredisë njëditore nuk gjeti asnjë përdorim gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë gjysmës së parë të vitit 2009.

**Grafik 1:** Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 (me çmim blerjeje).



## 2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Banka e Shqipërisë me synim shmangien e çrregullimeve në tregun valutor vazhdoi ndërhyrjen në këtë treg, duke shitur valutë në masën 1.93 miliardë lekë. Këto ndërhyrje u përqendruan kryesisht në muajin prill dhe maj.

## 2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Kështu, shitjet me Ministrinë e Financave gjatë tremujorit të dytë llogariten në 6.99 miliardë lekë. Vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave për këtë periudhë ishte 5.87 miliardë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 83.53 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)).

<b>Institucioni financiar</b>	<b>Blerje të valutës (në milionë lekë)</b>	<b>Shitje të valutës (në milionë lekë)</b>
MINISTRIA E FINANCAVE	5,867.00	6,988.00
TE TJERA (IDA, IBRD)	83.53	